



TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

Emri i NSH-së:	Enti i Mjekësisë për Terapi Fizikale me Rehabilitim Banja e Pejës (“Ndërmarrja”)
Emri i Ndërmarrjes së Re:	Ndërmarrja e Re Hotel Onix Banja e Pejës dhe Ilixhe Sh.P.K. (“Ndërmarrja e re”) <i>Ndërmarrja e Re e propozuar përfshin objektet e Hotel “Onix”, Hotel “Park” Hotel “Ilixhe”, Hotel “Termal” dhe parku.</i>
Vendndodhja:	Banjë, Komuna u Istogut, Regjioni Pejë
Biznesi/Spektori:	Institucion Rehabilitues
Prodhimet:	Hoteli dhe Ilixha kanë ofruar trajtime mjekësore, terapi fizikale, dhe programe rehabilitimi duke përdorur ujin e ngrohtë natyral nga burimi. Profesionistët mjekësor pohojnë se këto ujëra kanë fuqi shëruese për reumatizëm, kancer, artrit, sëmundje të zemrës dhe të ngjashme. Ekziston mundësia për zhvillimin e Ilixhes si klub vendor dhe Ilixhe shëndetësore me restorante, qendra sportive, pishina dhe të ngjashme. Ilixha ka shtrirje atraktive ku mund të zhvillohen aktivitete tjera siç janë: tenisi, mini-golf, birila, shigjetim, vrapim, basketboll e tjera. Vlen të ceket se ky Hotel është ndër më të mëdhenjtë në rajon.
Tregu:	Për shkak të reputacionit të saj Ilixhja i josh klientët, kryesisht për arsye mjekësore. Siç është përkthyer më lartë, me investimet e përshtatshme ekziston mundësia për shndërrimin e Ilixhes në qendër të konference rekreative dhe pushimi duke u bazuar në lokacionin qendror dhe qasje të lehtë. Industria turistike e Kosovës është e pa zhvilluar kështu që do të jetë atraksion kryesor në industrinë e ardhshme.
Konkurrenca:	Në Kosovë ekziston një objekt i ngjashëm në regjionin e Gjilanit. Objektet tjera të tilla ndodhen në Maqedoni, Bullgari dhe Slloveni. Megjithatë, ato janë të promovuara më tepër si objekte mjekësore e jo objekte pushimi.
Punonjësit:	Ndërmarrja punëson përafërsisht 145 punëtorë nga të cilët një numër i konsiderueshëm i profesionistëve mjekësorë.

Asnjë informacion rreth ndërmarrjes i paraqitur në këto të dhëna nuk është i garantuar. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dokumentet për ofertim. Ata të cilët dëshirojnë të dorëzojnë ofertë duhet të bazohen në hulumtimin e tyre. Investitorët e mundshëm rekomandohen të kryejnë hulumtimin e tyre paraprak para se të dorëzojnë ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të dhëna për ndërmarrjen janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme lidhur me dhënie të informatave publikut mbi kandidatët për privatizim dhe mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: <http://www.pak-ks.org>

Ndërtesat dhe tokat: Ndërmarrja e Re përfshin tokë përafërsisht 26 ha me përafërsisht 38.000 m² sipërfaqe të ndërtesave.

Ilixhja përfshinë hotelin – qendrën e Ilixhes me restorante dhe objekte tjera me më shumë se 20.000 m². Përveç kësaj janë dhomat e tretmanit për hidroterapi, parafino terapi, elektro-terapi dhe palestra për ushtrime fizioterapi. Ndërtesa gjithashtu përfshinë pishinën e mbyllur të madhësisë olimpike. Dhe shumë pishina për terapi. Te gjitha pishinat dhe te ngjashme janë të furnizuar me ujë të Ilixhes. Për më tepër, ekziston edhe salla e teatrit me 200 ulëse.

Brenda kompleksit ekzistojnë edhe tri hotele/ndërtesa, Hotel Ilixhja me kapacitet prej 45 shtretër dhe sipërfaqe prej 1,800 m², Hotel “Park” me kapacitet prej 120 shtretër me sipërfaqe prej 6,000 m² dhe Hotel “Termal” me sipërfaqe prej 8,000 m².

I tërë kompleksi është i lidhur me ngrohje qendrore.

Detyrimet që do të barten:

1) Detyrimet neto të NSh-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjokat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;

2) Detyrimet e papaguara të NSh-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;

3) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;

4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshire pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSh-se në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:

a) Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;

b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSh-se.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Imazh i Ndërmarrjes
së Re:**



Informatat:

Departamenti i Shitjes
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 -1255
Fax: + 381 (0) 38 248 076
www.pak-ks.org

**Dokumentet e
Ofertimit:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rr. Ilir Konushevci Nr.8
10000 Pristinë, Kosovë

Asnjë informacion rreth ndërmarrjes i paraqitur në këto të dhëna nuk është i garantuar. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dokumentet për ofertim. Ata të cilët dëshirojnë të dorëzojnë ofertë duhet të bazohen në hulumtimin e tyre. Investitorët e mundshëm rekomandohen të kryejnë hulumtimin e tyre paraprak para se të dorëzojnë ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të dhëna për ndërmarrjen janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme lidhur me dhënien e informatave publikut mbi kandidatët për privatizim dhe mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: <http://www.pak-ks.org>